



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:197102

Datë: 24.10.2023

Numri i dokumentit: 04823580

P.nr.3081/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Penal, me gjyqtarin Ertan Sejfulla, bashkëpunëtorin profesional Eduart Aliu në çështjen penale kundër të pandehurit E.Z, për shkak se ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe të pandehurës E.U për shkak se e ka kryer veprën penale Lajmërim apo Kallëzimi i Rremë nga neni 382 paragrafi 1 të KPRK-së, te akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.4936/2023 datë 08.09.2023, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më datë 24.10.2023, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.4936/2023 datë 08.09.2023, andaj gjykata konform nenit 495 të KPPRK-së kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Kundër të pandehurve

- **E.Z**, nga i ati, e ëma, e gjinisë, i lindur me datë,, banon në rrugën “.....”, i pa, i gjendjes së mesme, ka të kryer shkollën e, numër personal, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës,
- **E.U**, nga i ati, e ëma, gjinisë, e lindur me, e pa, ka të kryer shkollën e, gjendjes së, me numër personal, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës,

JANË FAJTORË

S e p s e:

- I. Me datë 12.07.2023, rreth orës 22:05, në rrugën “.....”, në, konkretisht në lokalit “.....”, i pandehuri E.Z, me qëllim të shkaktimit të frikësimit dhe ankthit seriozisht e kanos me fjalët se do ta privoj nga jeta të dëmtuarën E.U, ashtu që si rrjedhojë e një mosmarrëveshje të mëparshme që e dëmtuara ishte pasur me babain e të pandehurit M.Z, i pandehuri fillimisht shkon tek lokali “.....”, i cili gjendet në Rr.”.....”, në, por pasi që aty nuk e takon të dëmtuarën E.U, shkon në lokalit “.....”, i cili gjendet në Rr. “.....” në, aty e takon motrën e të dëmtuarës dëshmitaren Sh.U, ku fillimisht e ofendon të njëjtën dhe me pas i drejtohet me fjalët kërcënuese “*ku osht e ku sosht motra jote pa e vra pa e ngre zhag nuk e la*”, ku pas kësaj dëshmitarja e telefonon të dëmtuarën dhe i tregon për rastin, me ç’rast i pandehuri me veprimet e tij tek e dëmtuara ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri për jetën e saj.
- me këtë i pandehuri E.Z ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.
- I. Me datë 12.07.2023, rreth orës 23:15, në Stacionin Policor në, e pandehura E.U, benë lajmërim të rremw të personit zyrtar nga Policia e Kosovës, se personi M.Z, ka kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, edhe pse ai e di se vepra nuk është kryer, në atë mënyrë që i pandehuri në cilësinë e të dëmtuarës kishte deklaruar se personi M.Z e ka sulmuar fizikisht duke i shkaktuar lëndime trupore, ku edhe pranuar tretman mjekësor, ndërsa me datë 19.07.2023 në cilësinë e të pandehurës e njëjta ka pranuar që ka dhënë deklaratë të rremë me datë 12.07.2023, ku ndër të tjera ka shtuar se ditën kritike nuk ka qenë vetvetja 100 % për shkak se isha nervoz, dhe pas sigurimit te video incizimit nga vendin i ngjarjes vërtetohet se personi M.Z, nuk e ka sulmuar fizikisht por vetëm e mbante për duar që ta qetësoj të pandehurën, me ç’rast me këtë veprim e pandehura ka bërë lajmërim të rrejshëm në Stacionin Policor në
- me këtë e pandehura E.U. ka kryer veprën penale Lajmërim apo Kallëzimi i rremë nga neni 382 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 të KPRK, si dhe neneve 364 dhe 495, të KPPK-së, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- Të pandehurit **E.Z.** për veprën penale si në pikën **I** të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton **Dënim me Gjobë** në shumën prej **200 (dyqind) Euro**, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi,

- Të pandehurës **E.U.** për veprën penale si në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton **Dënim me Gjobë** në shumën prej **200 (dyqind) Euro**, të cilin dënim e pandehura është e obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi
- Nëse dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurve në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, do të ua zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
- Të pandehurit dënimin e shqiptuar, mund ta paguajnë, me dy këste. Mundësia e pagesës me këste do t'u revokohet nëse personat e dënuar nuk e paguajnë këstin me kohë.
- Obligohen te pandehurit që të paguajnë në mënyrë solidare shpenzimet procedurale atë për paushallin gjyqësor në shumën prej 30.00 (tridhjetë) €, në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 20.00 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.4936/2023 datë 08.09.2023, ndaj të pandehurve E.Z, për shkak se ka kryer veprën penale kanosja nga neni 181 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe të pandehurës E.U. për shkak se ka kryer veprën penale lajmërim apo kallëzimi i rremë nga neni 382 paragrafi 1 të KPRK-së dhe njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se te pandehurit vërtetë e kanë kryer veprën penale, për të cilën akuzohen.

Gjykata pasi shqyrtoi përmbajtjen e aktakuzës dhe kërkesës për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor nga ana e organit të ndjekjes, gjeti se të njëjtat janë përpiluar në përputhje me nenin 493 të KPPPK-së, andaj erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet nga neni 495 i KPPPK-së, që në këtë çështje penale pa u mbajtur fare shqyrtimi gjyqësor të marrë vendim për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: Raporti i datës 12.07.2023, Deklarata e të dëmtuarës E.U datës 12.07.2023, Deklarata e të dëmtuarës-dëshmitares Sh.U e datës 12.07.2023, Deklarata e dëshmitarit M.Z e datës 20.07.2023, Deklaratat e të pandehurës E.U datë 19.07.2023, Deklaratat e të pandehurit E. e datës 24.07.2023, CD me video incizim nga vendi i ngjarjes në lokalën “.....”, i cili gjendet në Rr.”.....”, në, CD me video incizim nga vendi i ngjarjes në lokalën “.....”, i cili gjendet në rrugën “.....”, në, si dhe shkresat tjera të lëndës

Duke u bazuar në këto që u ceken me lartë, gjykata konstaton se te pandehurit janë penalisht përgjegjëse për kryerjen e veprave penale atë se i pandehuri E.Z ka kryer veprën penale kanosja

nga neni 181 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe e pandehura E.U ka kryer veprën penale lajmërim apo kallëzimi i rremë nga neni 382 paragrafi 1 të KPRK-së

Gjykata, vlerësoi se me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim të nenit 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryerësit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, që në të ardhmen të pandehurit të kenë kujdes të shtuar që të mos bien në kundërshtim me ligjin, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngrit moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 paragrafi 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të Ligjit nr. 08/L-109.

Vendimin që palët e dëmtuara të udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civilë gjykata e mori në bazë të nenit 462 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 364 e 495, të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal

P.nr.3081/23, datë 24.10.2023

Gjyqtari,
Ertan Sejfulla

KËSHILLË JURIDIKE: Të pandehurit ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.